

ROMACTED

Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor

Zbatimi i planeve vendore: Rëndësia e monitorimit dhe vlerësimit





*Promovimi i qeverisjes së
mirë dhe fuqizimit Rom
në nivelin vendor*

Zbatimi i planeve vendore: Rëndësia e monitorimit dhe vlerësimit

Programi ROMACTED II

Promovimi i qeverisjes së mirë
dhe fuqizimit Rom në nivel vendor

Një program i përbashkët i

Bashkimit Evropian dhe

Këshillit të Evropës

Kontributorë:

Elona Dhëmbo

Elvana Gadeshi

Ky publikim u prodhuan me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon "©Këshilli i Evropës, 2024". Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohen Divizionit Romët dhe Udhëtarët, Departamenti i Antidiskriminimit.

@ Këshilli i Evropës, Nëntor 2024. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

Kopertina dhe faqesja: Grid Cartels shpk

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	4
SHKURTESA	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1. Hyrje në monitorim dhe vlerësim	9
1.1. Çfarë është monitorimi dhe vlerësimi (M&V)?	10
1.2. M&V dhe kërkimi	13
1.3. Të përbashkëtat dhe veçantitë e monitorimit dhe vlerësimit	14
1.4. Llojet e ndryshme të monitorimit dhe vlerësimit	15
2. Mbledhja dhe analiza e të dhënave në funksion të monitorimit dhe vlerësimit	19
2.1. Metodatat për mbledhjen e të dhënave	20
2.2. Mjetet për mbledhjen e të dhënave	21
2.3. Cilësia e të dhënave	22
2.4. Analiza e të dhënave	23
3. Monitorimi dhe vlerësimi i planeve vendore të veprimit dhe harmonizimi me strategjitë/planet kombëtare.	24
3.1. Çfarë është plani i M&V të një Plani Vendor të Veprimit (PVV)?	25
3.2. Hapa që duhet të ndiqen për hartimin e Planit të M&V	26
3.3. Udhëzuesi i treguesve	31



4. Metoda e Monitorimit dhe Vlerësimit me Pjesëmarrje (M&VP)	32
5. Harmonizimi i PVV-ve për pakicat rome dhe egjiptiane me Planin Kombëtar – rasti i raportimit përmes sistemit elektronik "ROMALB"	34
6. Përfundime dhe rekomandime	37
7. Rekomandime	39
8. Referenca	42
9. Shtojcat	44
Shtojca 1: Shembull i raportimit të ecurisë së treguesve	45
Shtojca 2: Modeli i raportimit narrativ vjetor të PVV-së (viti 2021)	46
Shtojca 3: Model Matrica për sistemin e Monitorim dhe Vlerësimit dhe Buxhetit të Planit Vendor të Veprimit	51
Shtojca 4: Shembull i pasaportës së treguesit të planit të M&V	52



SHKURTESA

DPSBGj	Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore
GKV	Grupet Komunitare të Veprimit
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
M&VP	Monitorim dhe Vlerësim me Pjesëmarrje
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NjVKSh	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
NjVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OECD	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (Organisation for Economic Cooperation and Development)
OShC	Organizata të Shoqërisë Civile
PVV	Plani Vendor i Veprimit
ROMALB	Sistemi Elektronik i Integruar i Treguesve të Planit Kombëtar të Veprimit për Pakicat Rome dhe Egjiptiane



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qeverisja e mirë është kusht i domosdoshëm për zhvillim të qëndrueshëm¹, nga i cili përfitojnë në mënyrë të drejtë të gjithë qytetarët, pavarësisht përkatësive të tyre. Që nga viti 2008, Këshilli i Evropës ka përmbledhur domethënien e qeverisjes së mirë në 12 parime të përfshira në Strategjinë për Inovacionin dhe Qeverisjen e Mirë në nivel vendor.² Ato mbulojnë çështje të tilla si pjesëmarrja, sjellja etike, sundimi i ligjit, efikasiteti dhe efektiviteti, transparencja, menaxhimi i mirë financiar dhe llogaridhënia. Këto parime kanë udhëhequr punën për hartimin e planeve vendore në bashkitë partnere në fazën e parë të projektit ROMACTED dhe do të vijojnë të jenë në themel edhe të proceseve për hartimin e planeve me bashkitë e shtuara rishtas në fazën e dytë të ROMACTED.

Ashtu si edhe në faza të tjera të planifikimit dhe zbatimit të një projekti, programi apo politike, këto parime do të duhet të formësojnë edhe proceset për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Veçanërisht, garantimi i pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes edhe gjatë fazës së monitorimit dhe vlerësimit janë thelbësore nën qasjen e Këshillit të Evropës për përfshirjen e këndvështrimit të të drejtave të njeriut në çdo ndërhyrje. Qëllimi është që ata që gëzojnë të drejta, të aftësohen dhe fuqizohen që të bëjnë të mundur vënien para përgjegjësisë të atyre që duhet të kryejnë detyra të caktuara dhe të kërkojnë respektimin e të drejtave të tyre nga ata.³

Ky dokument është një mjet që i shërben qëllimit për të realizuar procese monitoruese dhe vlerësuese të planeve vendore për përfshirjen e pakicave romë dhe egjiptiane, të cilët zbatojnë parimet e pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes. Monitorimi dhe vlerësimi janë pjesë thelbësore e menaxhimit të bazuar në rezultate, i cili siguron performancën më të mirë dhe përgjegjësinë më të lartë, duke ndjekur një kornizë të qartë dhe logjike për të planifikuar, menaxhuar dhe matur zbatimin e një ndërhyrjeje udhëhequr nga rezultatet e pritshme (rezultate dhe ndikim) sesa nga hyrje-daljet (inpute dhe outpute).⁴

- 1 Qeverisja e mirë është shpallur si një parakusht për politikën e zhvillimit nga Banka Botërore që në vitet 1990. Shiko <https://shtetiweb.org/2012/09/07/ceshte-qeverisja-e-mire-2/> dhe <https://www.worldbank.org/en/topic/governance/overview#1>
- 2 CoE (2008). 12 Principles of Good Governance, e aksesueshme në <https://www.coe.int/en/web/good-governance/12-principles>
- 3 CoE (2020). Council of Europe: Human Rights Approach Practical Guide for Co-operation Projects, Council of Europe, December 2020, f. 17.
- 4 CoE (2016). Council of Europe: Project Management Methodology Handbook 2016, Council of Europe, March 2016, f. 14 & 80.



Dokumenti ofron mundësinë për të kristalizuar konceptet kyçe në monitorim dhe vlerësim dhe për të thelluar kuptueshmërinë mbi rëndësinë e tyre. Ai ka një natyrë praktike duke ofruar jo vetëm njohuri, por edhe shembuj dhe mjete konkrete për realizimin e proceseve të monitorimit dhe vlerësimit, mbledhjen e të dhënave të vlefshme, harmonizimin e proceseve në nivel vendor me atë kombëtar, hapat që rekomandohen të ndiqen përgjatë punës, si dhe burimet që mund të shfrytëzohen.

Audienca e parë e këtij dokumenti janë stafet e bashkive dhe lehtësuesit e pakicave rome dhe egjiptiane që janë përfshirë tashmë në monitorimin e planeve vendore, megjithatë dokumenti i vlen kujtdo që është i/e interesuar për monitorimin dhe vlerësimin në përgjithësi, si dhe për mjete dhe shembuj për realizimin e tij në praktikë, veçanërisht në nivel vendor.



1

Hyrje në monitorim dhe vlerësim



1.1. Çfarë është monitorimi dhe vlerësimi (M&V)?

Monitorimi dhe vlerësimi (M&V) janë pjesë thelbësore të menaxhimit të bazuar në rezultate. Menaxhimi i bazuar në rezultate është një qasje, që siguron performancën më të mirë dhe përgjegjësinë më të lartë duke ndjekur një kornizë të qartë dhe logjike për të planifikuar, menaxhuar dhe matur zbatimin e një ndërhyrjeje udhëhequr nga rezultatet e pritshme (rezultate dhe ndikim) sesa nga hyrje-daljet (inpute dhe outpute).⁵ M&V janë pjesë konstruktive e çdo projekti, programi apo politike dhe domosdoshmëri për çdo program zhvillimor.⁶ M&V nuk duhet të shihen si diçka e përkohshme, apo si një barrë sa për të kënaqur kërkesat e donatorëve apo angazhimeve në nivele më të larta. Qëllimi kryesor i M&V është të masë shkallën me të cilën një plan operacional/veprimi është zbatuar siç është planifikuar dhe nëse po arrin me sukses rezultatet e synuara.

Monitorimi është një proces i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizimit të informacionit për të krahasuar se sa mirë një projekt, program apo politikë po zbatohet kundrejt rezultateve të pritshme. Monitorimi synon t'ju sigurojë menaxherëve dhe aktorëve kryesorë reagim të vazhdueshëm dhe tregues të hershëm të përparimit ose mungesës së tij në rrugën drejt arritjes së rezultateve të synuara. Në përgjithësi, monitorimi përfshin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi proceset e zbatimit, strategjitë dhe rezultatet, si dhe rekomandime për masa korigjuese që duhen ndërmarrë.⁷



Monitorimi është një pjesë integrale e menaxhimit operacional të përditshëm për të vlerësuar përparimin kundrejt objektivave të vendosura. Disa nga tiparet e tij janë:

- * Përfshin gjurmimin e inputeve, proceseve, aktiviteteve, rezultateve dhe impaktit kundrejt treguesve dhe, kur është e nevojshme, kërkon modifikimin e këtyre proceseve dhe aktiviteteve;
- * Mbështet menaxhimin efektiv përmes raporteve mbi performancën aktuale kundrejt asaj që ishte planifikuar ose pritur të ndodhte;

5 CoE (2016). Council of Europe: Project Management Methodology Handbook 2016, Council of Europe, March 2016, pp.14 & 80.

6 TANGO (2007). Monitoring and Evaluation Manual, Prepared for ADRA International Food Security Department, TANGO International, Inc. March 2007

7 IFRC (2007). Monitoring and Evaluation in a Nutshell. Planning, Monitoring, Evaluation and Reporting Department, IFRC.



- * Mjetet e monitorimit përdoren për identifikimin e hershëm të problemeve dhe adresimin sa më të hershëm të tyre;
- * Monitorimi bazohet në të dhënat e mbledhura para dhe gjatë ndërhyrjeve/veprimtarive;
- * Informacioni i kërkuar për monitorim mund të futet dhe të analizohet në një sistem të posaçëm (ROMALB është një shembull);
- * Saktësia e të dhënave të mbledhura për qëllime monitorimi dhe mënyra për të vlerësuar saktësinë e tij janë aspekte të rëndësishme të monitorimit.⁸

Zakonisht, monitorimi i paraprin dhe formon bazën për vlerësimin. Monitorimi mund të përdoret si pjesë e vlerësimit, ashtu si dhe mjetet e vlerësimit mund të përdoren edhe për qëllime monitorimi.



Vlerësimi i referohet procesit të vlerësimit sistematik dhe objektiv të një projekti, programi ose politike që është në zbatim e sipër ose që ka përfunduar, si mbi aspektin e hartimit, ashtu edhe për zbatimin dhe rezultatet e arritura. Vlerësimi përcakton nivelin e përbushjes së objektivave, efikasitetin, efektivitetin, relevancën, koherencën, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e një ndërhyrjeje. Sipas OECD, gjashtë janë kriteret për vlerësim:

- * relevanca ose përshtatshmëria: a po bëhet gjëja e duhur përmes ndërhyrjes së ndërmarrë?
- * koherenca – sa mirë përshtatet kjo ndërhyrje?
- * efektiviteti – a po i arrin ndërhyrja e ndërmarrë objektivat e vendosura?
- * eficientia – sa mirë po përdoren burimet?
- * impakti – çfarë ndryshimi bën kjo ndërhyrje?
- * qëndrueshmëria – a do të zgjasin në kohë përfitimet që vijnë prej saj?⁹

8 South African Management Development Institute (SAMDI) (2007). Training Manual Module 3: The planning and design of outcomes-based learning, https://amdin.africa/archive/documents/d00104/SAMDI_TOT_Module_3.pdf

9 Shiko për më shumë OECD (2021). Applying Evaluation Criteria Thoughtfully, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/543e84ed-en>.



Vlerësimet e ndërhyrjeve të mëparshme shërbejnë si vlerësime ex-ante (paraprake) për nisma dhe ndërhyrje pasuese. Të dhënat bazë, fillestare, (ndryshe të njohura si baseline) janë të dhëna që masin treguesit/kushtet përpara se të fillojë një projekt/ndërhyrje, për të mundësuar më pas krahasimin. Një proces vlerësimi duhet të sigurojë të dhëna që janë të besueshme dhe të dobishme, duke mundësuar përfshirjen e mësimeve të nxjerra në procesin e vendimmarrjes.¹⁰

Vlerësimi është një mjet shumë i mirë për vendimmarrje për t'u përfshirë në ciklin e planifikimit dhe menaxhimit e performancës së çdo qeverisjeje (qendrore apo vendore).

- * Ai përfshin një vlerësim sistematik të pikave të forta dhe të dobëta të hartimit, zbatimit dhe rezultateve të ndërhyrjeve të përfunduara ose që janë në zbatim e sipër;
- * Qëllimi i tij është të ndihmojë në përmirësimin e këtyre ndërhyrjeve;
- * Objektivi kryesor i tij është të sigurojë informacion mbi mësimet e nxjerra nga puna e deritanishme për të ndikuar në planifikimin e ardhshëm;
- * Është një proces sistematik me tregues ose kritere kundrejt të cilave duhet të vlerësohet puna e kryer;
- * Të dhënat, aktivitetet, rezultatet dhe ndikimet janë elementë përbërës të tij.

Vlerësimi mund të gjejë vend në faza të ndryshme të një ndërhyrjeje, për shembull zbatimi i një projekti/programi/politike mund të ketë nevojë të vlerësohet në momente të caktuara si p.sh. në fund të një faze të caktuar, në fund të një viti financiar ose në fund të të gjithë projektit/planit. Vlerësimi i ndikimit mund të ketë nevojë të zhvillohet në një periudhë të caktuar kohore pas përfundimit të ndërhyrjes.

Për realizimin e M&V ngrihen sisteme M&V, që mundësojnë përcaktimin e ndikimit të projekteve, programeve apo politikave të caktuara. Kur hartohet dhe zbatohet në mënyrën e duhur, një sistem M&V-mban projektet në shina dhe siguron informacion për të rivlerësuar prioritetet e vendosura.

10 IFRCs (2007). Monitoring and Evaluation in a Nutshell. Planning, Monitoring, Evaluation and Reporting Department, IFRCs. https://sswm.info/sites/default/files/reference_attachments/RED%20CROSS%20and%20RED%20CRESCENT%202007%20Monitoring%20and%20Evaluation%20in%20a%20Nutshell.pdf



1.2. M&V dhe kërkimi

Monitorimi dhe vlerësimi nuk mund të kuptohen pa kërkimin (hulumtimin). Kërkimi është procesi sistematik i mbledhjes së të dhënave.



Ka dy tipa kryesorë të kërkimit: **kërkimi bazë** dhe **kërkimi i aplikuar**. Kërkimi bazë ka të bëjë me studimin e marrëdhënieve midis variablave, ndërsa kërkimi i aplikuar zakonisht përpiqet të zbatojë metodat dhe gjetjet e kërkimit bazë në një situatë të caktuar. Vlerësimi është një degë e kërkimit të aplikuar që përpiqet të përshkruajë marrëdhënie shkak-pasojë brenda një konteksti të caktuar.¹¹



Ka dy lloje të mbledhjes së të dhënave: **mbledhje e të dhënave primare (parësore)**, e cila mund të realizohet përmes metodave të ndryshme si sondazhet, intervistat e thelluara, fokus-grupet, studimet e rastit etj., dhe **mbledhje e të dhënave sekondare (dytësore)**, e cila mund të realizohet përmes mbledhjes dhe analizës së databazave ekzistuese, literaturës dhe punimeve të mëparshme. Kur të gjitha të dhënat janë mbledhur, realizohet tekëndëzimi i tyre.

Trekëndëzimi i të dhënave është përdorimi i disa metodave apo/dhe i disa burimeve të të dhënave për të zhvilluar një kuptueshmëri sa më të gjithanshme të fenomenit.¹² Trekëndëzimi shihet edhe si një strategji e kërkimit cilësor për të testuar vlefshmërinë e gjetjeve përmes konvergjencës së informacionit që vijnë nga burime të ndryshme. Gjithë procesi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave synon rritjen e kuptueshmërisë së një fenomeni për të cilin kemi interes/shqetësim.¹³

11 Burch, P., & Heinrich, C. (2016). Mixed methods for policy research and program evaluation. SAGE Publications, Inc. <https://www.doi.org/10.4135/9781483398259>

12 Patton, MQ. (1999). "Enhancing the quality and credibility of qualitative analysis." HSR: Health Services Research. 34 (5) Part II. pp. 1189-1208.

13 Johnson, G. (2002). Research methods for public administrators. Westport, CT: Quorum Books. Chicago



1.3. Të përbashkëtat dhe veçantitë e monitorimit dhe vlerësimit

Siç u paraqit më sipër, monitorimi dhe vlerësimi janë dy procese të ndryshme, por me mjaft të përbashkëta. Në këtë seksion sjellim monitorimin dhe vlerësimin në një dimension krahasues për të bërë edhe më të qarta specifikat e tyre.

Tabela 1. Monitorimi kundrejt Vlerësimit

	Dimensioni krahasues	Monitorimi	Vlerësimi
1.	Kur realizohet?	Vazhdimisht	Periodikisht
2.	Fokusi/qëllimi?	Ndjekja e mbarëvajtjes	Të gjykosh, të nxjerrësh mësim
3.	Nga kush realizohet?	Realizohet së brendshmi	Realizohet së jashtmi ose së brendshmi (por nga një njësi tjetër, jo ajo zbatuese)
4.	Cilës pyetje i përgjigjet?	Çfarë është duke ndodhur?	Përse kemi ato rezultate që na tregojnë të dhënat e monitorimit?

Përgjatë proceseve monitoruese dhe vlerësuese paraqiten mundësi dhe pengesa specifike. Ajo çka është me rëndësi është që këto të njihen paraprakisht, në mënyrë që ne të jemi në gjendje të përdorim pikat tona të forta dhe të kapërcejmë pengesat e hasura.



1.4. Llojet e ndryshme të monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi dhe vlerësimi realizohen në disa faza të një programi. Në çdo fazë mblidhen të dhëna të ndryshme, që së bashku përdoren për të dëshmuar se si është realizuar projekti/plani dhe çfarë ka sjellë si rezultat zbatimi i tij. Është e rëndësishme të identifikojmë që në fillim se si do të mblidhet informacioni për secilin nivel të vlerësimit. Po kështu duhet të mbahet në konsideratë se disa nga këto faza mund të mbivendosen. Pika fillestare është krijimi i një baseline kundrejt të cilit do të krahasohen të dhënat. Tabela e mëposhtme paraqet elementet përbërës të kuadrit të M&V, të cilat shpjegohen në vijim sipas FHI.¹⁴

Tabela 2. Elementet e kuadrit të M&V

Elementë të M&V			
Vlerësimi dhe kërkimi formativ	Monitorimi i inputeve, proceseve dhe outputeve	Vlerësimi i rezultateve (outcomes) dhe impaktit (ndikimit)	Analizat kosto-efektive
Pyetjeve që u përgjigjet secili element i M&V			
<ul style="list-style-type: none"> * A ka nevojë për ndërhyrje? * Kush ka nevojë për të? * Si duhet të ndodhë kjo? 	<ul style="list-style-type: none"> * Në ç'nivel janë realizuar aktivitetet e planifikuara? * Si (me ç'cilësi) janë ofruar shërbimet? 	<ul style="list-style-type: none"> * Çfarë rezultatesh vihen re? * Ç'tregojnë ato? * A është programi/politika duke bërë diferencën? 	<ul style="list-style-type: none"> * A ka nevojë që prioritetet e vendosura nga programi/politika të ndryshojnë/shtohen? * A ka nevojë/në ç'masë duhet të rishpërndahen burimet?

14 Fhi360 (2004) Monitoring HIV/AIDS Programs: A Facilitator's Training Guide; A USAID Resource for Prevention, Care and Treatment.



a. Vlerësimi dhe kërkimi formativ

I njohur ndryshe si Vlerësimi Formativ i Nevojave, ai realizohet gjatë fazës së planifikimit (ose ri-planifikimit) të një programi/politike për të identifikuar nevojat e programit dhe për të zgjidhur problematikat e identifikuar para se ai të zbatohet më gjerësisht. Krahasimi me të dhënat e baseline është thelbësor në këtë fazë. Kjo është faza në të cilën ka një fleksibilitet dhe liri më të madhe për të marrë vendime sesi do të procedohet në vazhdim.

Gjatë kësaj faze adresohen çështjet e mëposhtme:

- a. Identifikimi i nevojës për ndërhyrje;
- b. Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave realistë;
- c. Identifikimi i strategjive për realizimin e ndërhyrjes;
- d. Vendosja e targeteve të programit.

Për realizimin e vlerësimit formativ të nevojave mund të përfshihen një sërë mjedesh: rishikimi i informacionit/të dhënave ekzistuese (si p.sh. të dhëna sekondare nga databaza ekzistuese, literatura etj.); diskutimet në fokus grupe; intervistat e thelluara individuale; vëzhgimet me pjesëmarrje; sondazhe të shkurtra me pyetësorë të strukturuar, etj. (që sigurojnë të dhënat parësore). Për këtë lloj vlerësimi duhet të mbajmë në konsideratë se ka kufizimet e veta, ku kryesori lidhet me faktin se gjetjet e tij nuk mund të përgjithësohen për projekte/ programe/politika të tjera.

b. Monitorimi

Siç u njohëm edhe më herët, monitorimi është proces rutinë i mbledhjes së të dhënave me qëllim matjen e progresit drejt objektivave të projektit/programit dhe në krahasim me baseline. Ekzistojnë tre fusha kryesore të informacionit që kërkohen në një sistem monitorimi:

- 1. Inputet** – burimet që hyjnë në punë për zbatimin e projektit ose programit. Këto mund të përfshijnë stafin, financat, materialet e ndryshme dhe kohën.
- 2. Procesi** – grupi i aktiviteteve në të cilat janë përdorur burimet e programit (njerëzore dhe financiare) për të arritur rezultatet e pritura nga programi (p.sh., numri i trajnimeve, numri i workshopeve, etj.)
- 3. Rezultatet** – rezultatet e menjëhershme të marra nga programi përmes ekzekutimit të aktiviteteve (p.sh. numri i mallrave të shpërndarë, numri i stafit të trajnuar, numri i njerëzve tek të cilët kemi mbërritur me ndërhyrjen tonë ose numri i njerëzve të shërbyer).



Monitorimi adreson pyetjet e mëposhtme:

- * Deri në çfarë mase janë realizuar aktivitetet e planifikuara? A po bëjmë përparim drejt arritjeve të objektivave tona?
- * Çfarë shërbimesh ofrohen, kujt, kur, sa shpesh, për sa kohë dhe në çfarë konteksti?
- * Sa mirë ofrohen shërbimet?
- * Cila është cilësia e shërbimeve të ofruara?
- * Sa është kostoja për njësi shërbimi?

Monitorimi gjithashtu vlerëson shkallën në të cilën një program ose projekt:

- a. Është ndërmarrë në mënyrë konsistente me secilin plan të projektimit ose zbatimit.
- b. Drejtohet drejt grupit specifik të synuar prej tij.

c. Vlerësimi

Vlerësimi është përdorimi i metodave të kërkimit social për të hetuar në mënyrë sistematike efektivitetin e një programi. Kriteret kryesore rreth të cilave ngihet vlerësimi janë: relevanca (kombinim i rëndësisë dhe përshtatshmërisë), eficientia, efektiviteti, ndikimi i mundshëm, koherenca dhe qëndrueshmëria. Vlera e shtuar në modelin e inkurajuar nga Këshilli i Evropës është edhe qasja nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut. Kjo e fundit është një kriter/vlerë e shtuar për logjikën e vlerësimit sipas Këshillit të Evropës.¹⁵

Vlerësimi përdoret:

- 1. Për të vlerësuar ndryshimet në grupin e synuar** (p.sh. ndryshimet në një sjellje të caktuar që kemi pasur qëllim ta reduktojmë);
- 2. Për të vlerësuar masën në të cilën objektivat janë përmbushur;**
- 3. Për të gjurmuar rezultatet dhe ndikimin e programeve ose projekteve në një nivel më të gjerë të popullsisë, në krahasim me nivelin e programit ose projektit.**

15 CoE (2016). Council of Europe: Project Management Methodology Handbook 2016, Council of Europe, March 2016, p.86.



Vlerësimi adreson pyetjet e mëposhtme:

- * 1. Cilat rezultate vërehen?
- * 2. Çfarë nënkuptojnë rezultatet?
- * 3. A po bën programi ndryshimin e pritur?

d. Analizat kosto-efektive

Kjo analizë i ndihmon menaxherët, planifikuesit dhe vendimmarrësit të marrin vendime në lidhje me përdorimin e buxheteve dhe financave të tyre. Me këtë informacion vendimmarrësit mund të bëjnë zgjedhje se si të shpërndahen fondet e tyre dhe të vendosin nëse fondet po shpenzohen apo jo në mënyrë të përshtatshme, apo nëse ato do duhet të rishpërndahen. Kjo nënkupton kombinimin e rezultateve të të dhënave të monitorimit dhe të dhënave mbi kostot.



2

Mbledhja dhe analiza e të dhënave në funksion të monitorimit dhe vlerësimit



2.1. Metodatat për mbledhjen e të dhënave

Për realizimin e monitorimit dhe vlerësimit është e domosdoshme të përdorim një sërë metodash kërkimore për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Mbledhja e të dhënave është thelbësore për M&V. Mënyra më klasike për të klasifikuar metodat për mbledhjen e tyre është duke i grupuar ato në metoda sasiore dhe metoda cilësore.



Metodat sasiore (kuantitative) – janë ato metoda që mbështeten në një qasje të strukturuar ose të standardizuar, si për mbledhjen ashtu edhe për analizën e të dhënave numerike. Metodatat sasiore mund të jenë të dobishme në çdo situatë monitorimi/vlerësimi pasi gati çdo problematikë/fenomen mund të matet numerikisht. Disa shembuj të përdorimit të metodave sasiore janë censuset, sondazhet, vlerësimet e klientëve për shërbimet, etj.



Metodat cilësore (kualitative) – janë ato që përgjithësisht bazohen në një sërë mjeteve gjysmë të strukturuar apo të pastrukturuar, të cilat gjenërojnë informacion të detajuar dhe përshkruar. Disa nga instrumentet më të përdorur janë fokus-grupet dhe intervistat e thelluara.

Të dyja këto metodologji kryesore mund të përdoren shumë mirë edhe të kombinuara, për të monitoruar dhe vlerësuar të njëjtin fenomen.¹⁶ Për shembull, ju mund të realizoni një sondazh për të matur sa i përhapur është një fenomen dhe më pas të bëni diskutime në fokus-grupe për të kuptuar më shumë mbi natyrën/dinamikën e problemit. Kjo mund të ndodhë në mënyrë sekuenciale (në fillim njëra metodë, pastaj tjetra – të njohura si QUAN-QUAL dhe QUAL-QUAN) ose të realizohen të dyja paralelisht. Zgjedhja përcaktohet nga konteksti dhe qëllimi i mbledhjes së të dhënave.¹⁷

16 Burch, P., & Heinrich, C. (2016). Mixed methods for policy research and program evaluation. SAGE Publications, Inc. <https://www.doi.org/10.4135/9781483398259>

17 Schoonenboom, J., & Johnson, R. B. (2017). How to Construct a Mixed Methods Research Design. *Kolner Zeitschrift für Soziologie und Sozialpsychologie*, 69(Suppl 2), 107–131. <https://doi.org/10.1007/s11577-017-0454-1>



2.2. Mjetet për mbledhjen e të dhënave

Ndërkohë që metoda e mbledhjes dhe analizës së të dhënave i referohet modelit ose qasjes shkencore të përdorur, mjetet për mbledhjen e të dhënave iu referohen instrumenteve që përdoren për mbledhjen e informacionit përmes një mënyre të caktuar. Mjete si pyetësorët e standardizuar, check-listat etj. janë thelbësore për metodat sasiore. Pyetësorët me pyetje të hapura, intervistat e thelluara, fokus-grupet janë instrumente që mbledhin të dhëna cilësore.¹⁸

Për administrimin e instrumenteve (p.sh. një pyetësori) mund të përfshihen anëtarë të stafit, mund të angazhohen ekspertë ose mund të jetë me vetë-administrim (të plotësohet nga vetë pjesëmarrësit – përfitues, klientë, etj.). Në çdo rast do të duhet të tregohet kujdes për çështje që lidhen me konfidencialitetin, privatësinë, vendin e mbledhjes së të dhënave, etj. Disa nga mjetet kryesore që përdoren për të mbledhur të dhëna në funksion të monitorimit dhe vlerësimit mund të jenë regjistrimet/sign-in, format e plotësuar për regjistrim, check-listat, format e vlerësimit të plotësuar në një aktivitet të caktuar, dosjet e klientëve (p.sh. në rastin e shërbimeve psiko-sociale) ose pacientëve (p.sh. në rastin e shërbimeve shëndetësore), pyetësorët, etj.¹⁹

Si edhe në faza të tjera të planifikimit dhe zbatimit të një projekti/programi/politike, edhe në M&V është e domosdoshme që t'i qëndrojmë parimeve të pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes. Këto janë parime thelbësore në qasjen e Këshillit të Evropës për përfshirjen e këndvështrimit të të drejtave të njeriut në çdo ndërhyrje. Qëllimi është që ata që gëzojnë të drejta të aftësohen dhe fuqizohen që të mbajnë përgjegjësi ata që duhet të kryejnë detyra të caktuara dhe të kërkojnë të drejtat e tyre nga ata.²⁰ (Angazhimi i përfaqësuesve nga grupet e përfituesve në këto procese është garanci për më shumë transparencë dhe objektivitet në realizimin e monitorimit dhe vlerësimit të ndërhyrjeve të ndryshme. Angazhimi me shoqërinë civile është thelbësor për mundësimin e këtij synimi, pasi organizatat e shoqërisë civile (OSHC) kanë mundësi për të arritur, fuqizuar, përfaqësuar dhe mbrojtur personat/grupet e cenueshëm.²¹

18 Creswell, J. W., & Creswell, J. D. (2018). *Research design: qualitative, quantitative, and mixed methods approach*. Fifth edition. Los Angeles: SAGE.

19 Fhi360 (2004) *Monitoring HIV/AIDS Programs: A Facilitator's Training Guide; A USAID Resource for Prevention, Care and Treatment*.

20 CoE (2020). *Council of Europe: Human Rights Approach Practical Guide for Co-operation Projects*, Council of Europe, December 2020, <https://rm.coe.int/coe-humanrightsapproach-r01-v05-light-final-version/1680a22410> p.17.

21 Ibid.



2.3. Cilësia e të dhënave

Të dhënat që mbledhim kanë vlerë/kuptim nëse janë mbledhur me cilësinë më të lartë të mundshme. Cilësia në mbledhjen e të dhënave duhet të monitorohet në çdo hap të procesit. Garantimi i monitorimit të cilësisë së të dhënave që mbledhen nuk duhet të lihet apo të besohet në dorën e vetëm një personi/anëtari stafi. Cilësia e të dhënave është përcaktuese për vlefshmërinë e gjetjeve. Ka një sërë masash që mund të merren për të garantuar cilësinë e të dhënave. Ato, të gjitha, kanë një emërues të përbashkët që është planifikimi dhe mbikqyrja e mirë e të gjithë procesit. Për të garantuar cilësinë e të dhënave ju duhet të:

- * Zhvilloni qëllim, objektiva, tregues dhe pyetje kërkimore sa më të qarta;
- * Planifikoni mirë si mbledhjen, ashtu edhe analizën e të dhënave;
- * Pilotoni metodat/instrumentet që do të përdorni;
- * Trajtoni stafin që do të merret me M&V dhe mbledhje të dhënash;
- * Përfshini kontrole të cilësisë së të dhënave në të gjitha hapat e procesit;
- * Bëni kontrole të rregullta;
- * Ndërmerrni hapa për të adresuar problematikat e identifikuara.

Disa nga llojet e gabimeve që bëhen në hedhjen e të dhënave në sistemet e M&V janë:

- * **Shkëmbimet/transpozimet** – një shembull është kur numri 43 futet si 34. Gabimet e transpozimit zakonisht shkaktohen duke shtypur gabim shifrat.
- * **Gabimet e kopjimit** – një shembull është kur 1 futet si 7; një tjetër është kur numri 0 futet si shkronja O, e kështu me radhë.
- * **Gabime në kodim** – vendosja e kodit të gabuar. Për shembull, një subjekt i intervistimit ka rrethuar alternativën 1 = Po, por koduesi vendos 2 = Jo, gjatë procesit të kodimit.
- * **Gabime në regjistrim të dhënash** – rezultojnë kur një person që plotëson një formular vendos numrin në pjesën e gabuar ose bën një renditje të pasaktë.
- * **Gabimet e konsistencës** – ndodhin kur dy ose më shumë përgjigje në të njëjtin pyetësor, për të njëjtën gjë, janë kontradiktore. Për shembull, nëse të dhënat për datën dhe moshën e lindjes nuk përputhen.
- * **Gabimet e vargut (range)** – ndodhin kur një e dhënë qëndron jashtë kufijve të mundshëm të vlerave që mund të marrë. Për shembull, nëse përgjigjet që mund të marrë një pyetje shtrihen në vlerat nga 5 deri në 10, por janë futur vlera të tilla si 4, 11, etj.



Kur gjeni gabime të tilla, fillimisht do të duhet të mirëpërcaktoni burimin e gabimit në mënyrë që të kuptohet se si mund të adresohet. Disa prej këtyre gabimeve mund të zgjidhen direkt në zyrë, për të tjerat mund të ketë nevojë të dilet në terren, të bëhen verifikime, etj. Sipas mundësive, çdo gabim i identifikuar duhet të korrigohet.

2.4. Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave të mbledhura në funksion të M&V nuk nënkupton domosdoshmërisht nevojë për analiza të avancuara, me programe të specializuara. Në thelb, procesi i analizës së të dhënave kërkon që ju të shikoni se ç'tregojnë të dhënat në raport me pyetjet që kishit ngritur dhe përgjigjet që prisnit të merrnit. Për shembull, analizë është edhe të shikoni se ku jeni sipas të dhënave aktuale dhe ku duhet të ishit, sipas treguesve që keni të përcaktuar në baseline dhe në planin tuaj. Sigurisht, gjetjet kërkojnë edhe interpretim, si dhe mund të çojnë drejt nevojës për të mbledhur edhe të dhëna të tjera/shtesë. Tabela e mëposhtme jep disa shembuj orientues për llojet e analizave që mund të përdorni në varësi të qëllimit.

Tabela 3. Kategori të analizës së të dhënave

Qëllimi/fokusi	Teknikat	Pyetjet
Performanca	<ul style="list-style-type: none"> * Krahasimi i performancës aktuale me atë të synuar dhe me baseline. * Krahasimi i performancës aktuale me atë të një viti më parë. * Analizimi i tendencave të vërejtura në performancë. 	<ul style="list-style-type: none"> * A është programi/politika në shina? * A i kemi arritur targetet e vendosura? Pse? * Si krahasohet kjo periudhë e vlerësuar në raport me ato të mëparshme? * Çfarë ndodhi që nuk e prisnim? A duhet të rishikohen targetet e vendosura?
Variacioni nga një grup/vend në një tjetër	<ul style="list-style-type: none"> * Krahasimi midis vendeve ose grupeve të ndryshme. 	<ul style="list-style-type: none"> * A po arrijmë siç duhet/kemi planifikuar tek të gjitha grupet/vendet?
Përputhja e programit të zbatuar me modelin e planifikuar	<p>Shembuj të komponentëve të analizës:</p> <ul style="list-style-type: none"> * Trajnimet. * Sistemet e referimit. * Shërbimet. 	<ul style="list-style-type: none"> * A është programi duke funksionuar siç pritej – në sasi dhe cilësi?



3

Monitorimi dhe vlerësimi i
planeve vendore të veprimit
dhe harmonizimi me
strategjitë/planet kombëtare



3.1. Çfarë është plani i M&V të një Plani Vendor të Veprimit (PVV)?

Një plan M&V është një dokument që ndihmon për të gjurmuar dhe vlerësuar rezultatet e ndërhyrjeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të PVV. Ai është një dokument i cili duhet referuar dhe përditësuar rregullisht. Ndërsa specifikat e planit të M&V të secilit plan vendor do të duken të ndryshme, ato të gjitha duhet të ndjekin të njëjtën strukturë bazë dhe të përfshijnë të njëjtët elementë kryesorë.

Një plan M&V duhet të përfshijë disa dokumente të rëndësishme, një pjesë e të cilave mund të jenë krijuar gjatë procesit të hartimit të planit vendor të veprimit, dhe disa që do të duhet të krijohen të reja. Për shembull, elementë të tillë si modeli logjik/kuadri logjik, teoria e ndryshimit dhe treguesit e monitorimit mund të zhvillohen nga përfaqësues të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore (NjVV) dhe me kontributin e dhënë nga palët kryesore të interesit gjatë zhvillimit të planit vendor të veprimit. Plani M&V i merr këto dokumente dhe zhvillon një plan të mëtejshëm, i cili do të ndihmojë në monitorimin e zbatimit të planit vendor të veprimit.

3.1.1. Pse duhet të hartoni një Plan M&V gjatë zhvillimit të një PVV-je?

Është e rëndësishme të zhvillohet një plan M&V para fillimit të zbatimit të një plani vendor, në mënyrë që të ketë një plan të qartë se cilat pyetje rreth zbatimit të PVV-së duhet të marrin përgjigje. Ky dokument do të ndihmojë stafin e NjVV-ve të vendosë se si do të mbledhë të dhëna për të gjurmuar treguesit, si do të analizohen të dhënat e monitorimit, si dhe se si rezultatet e dala nga grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave do të shpërndahen tek komuniteti, këshilli bashkiak, donatorët e PVV-së, si dhe tek anëtarët e stafit të bashkisë për përmirësimin e cilësisë së këtyre planeve në të ardhmen. Mbani mend, të dhënat e M&V në vetvete nuk janë të dobishme deri sa dikush do t'i vërë ato në përdorim! Një plan M&V do të ndihmojë të siguroheni që të dhënat po përdoren në mënyrë efektive për ta bërë PVV-në sa më efektive dhe për të qenë në gjendje të raportoni për rezultatet reale në fund të zbatimit të tij.

3.1.2. Kush duhet të hartojë Planin e M&V të një PVV-je?

Një plan M&V duhet të zhvillohet nga një staf i specializuar në NjVV, me kontribute nga stafi i programit, Grupet Komunitare të Veprimit (GKV), organizata vendore, anëtarë të komuniteteve (pakicat rome dhe egjiptiane), institucione të qeverisjes vendore në nivel vendor etj. OSHC-të që përfaqësojnë komunitetet rome dhe egjiptiane duhet të marrin pjesë në hartimin e PVV-ve. Kjo pjesëmarrje mund të jetë përmes diskutimeve në fokus-grupe në fazën e mbledhjes së të dhënave për vlerësimin e nevojave si dhe në seminarët sektoriale me institucionet e tjera vendore. Këto grupe pune duhet të vazhdojnë të funksionojnë pas miratimit të PVV-së. Në këtë mënyrë OSHC-të do të mund të mbajnë kontakte të vazhdueshme me pikat e kontaktit për pakicat rome dhe egjiptiane në NjVV, në institucionet qendrore në nivel vendor si dhe do të mund të përgjigjen me shpejtësi ndaj çdo problemi.



3.1.3. Kur duhet të hartohet një Plan M&V?

Një plan M&V duhet të zhvillohet në fillim të hartimit të PVV-së kur aktivitetet/masat janë duke u hartuar. Kjo do të sigurojë që ekziston një sistem për të monitoruar zbatimin e PVV-së dhe vlerësuar problematikat gjatë zbatimit, si dhe suksesin e tij.

3.2. Hapa që duhet të ndiqen për hartimin e Planit të M&V

1 Hapi 1: Identifikoni qëllimet, objektivat dhe masat/aktivitetet e PVV-së të NjVV-së

Hapi i parë për krijimin e planit të M&V është identifikimi i qëllimeve dhe objektivave të PVV-së. Nëse draft PVV-ja e ka një model logjik²² ose teori të ndryshimit, atëherë qëllimet e planit vendor ka shumë të ngjarë të jenë tashmë të përcaktuara. Sidoqoftë, nëse jo, plani i M&V është një vend i shkëlqyer për të filluar këtë punë. Identifikoni qëllimet dhe objektivat e programit!

Përcaktimi i qëllimeve të programit fillon me përgjigjen e tri pyetjeve:

- * Çfarë problemi/esh po përpiqet të zgjidhë PVV-ja?
- * Çfarë hapash po ndërmerren për të zgjidhur problemin/et?
- * Si do të informohet stafi i NjVV-së dhe anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane nëse zbatimi i PVV-së ka qenë i suksesshëm në zgjidhjen e problemit/ve?

2 Hapi 2: Përcaktoni treguesit

Pasi janë përcaktuar qëllimet, objektivat dhe masat e PVV-së, është koha për të përcaktuar treguesit për gjurmimin e progresit drejt arritjes së këtyre qëllimeve. Treguesit e programit duhet të jenë një përzierje e atyre që masin procesin e zbatimit të planit dhe atyre që masin rezultatet.

22 Modelet logjike janë mjete të planifikimit të PVV-së që përcaktojnë hyrjet, produktet, rezultatet e tij. Ato tregojnë rrjedhën logjike se si aktivitetet specifike të planit të veprimit çojnë në rezultatet e dëshiruara. Inputet përfshijnë burimet, kontributet dhe investimet e një plani vendor; produktet janë aktivitetet, shërbimet, që kryhen për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane dhe rezultatet janë ndryshimet që kanë ndodhur në cilësinë e jetës së pakicave rome dhe egjiptiane si rezultat i zbatimit të aktiviteteve të PVV-së.



Treguesit e procesit gjurmojnë progresin e zbatimit të PVV-së. Ato ndihmojnë për t'iu përgjigjur pyetjes: "A po zbatohen aktivitetet siç janë planifikuar?"

Disa shembuj të treguesve të procesit janë:

- * Numri i trajnimeve të mbajtura me ofruesit e shëndetit publik në lidhje me shërbimet shëndetësore për pakicat rome dhe egjiptiane;
- * Numri i aktiviteteve në terren të zhvilluara me pakicat rome dhe egjiptiane, në lidhje me çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore;
- * Numri i materialeve promocionale të përgatitura në gjuhën rome dhe/ose përfshirë figurat;
- * Numri i fushatave të informimit dhe edukimit në lidhje me sëmundjet seksualisht të transmetueshme si dhe shëndetin riprodhues, me pjesëmarrjen e pakicave rome dhe egjiptiane;
- * Numri i familjeve rome dhe egjiptiane, që përfitojnë nga shërbimet shtesë në rastet e pamundësisë për të paguar detyrimet financiare për një program strehimi.

Treguesit e rezultateve gjurmojnë se sa i suksesshëm, ose jo, ka qenë zbatimi i aktiviteteve të PVV-së drejt arritjes së objektivave të planit. Këta tregues ndihmojnë për t'iu përgjigjur pyetjes: "A ka sjellë ndryshime²³ në cilësinë e jetës së pakicave rome dhe egjiptiane zbatimi i aktiviteteve të planit?"

Disa shembuj të treguesve të rezultateve janë:

- * Përqindja e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane të cilët kanë akses të plotë dhe të përmirësuar në shërbimin e gjendjes civile;
- * Përqindja në rritje e përfituesve të programeve të strehimit të cilët i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane;
- * Numri i romëve dhe egjiptianëve të cilët kanë akses në shërbime cilësore shëndetësore dhe parandaluese;
- * Përqindja në rënie e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane të cilët raportohen me sëmundje seksualisht të transmetueshme.

23 Ndryshimet mund të jenë tek përmirësimi i aftësive profesionale, përmirësim të kushteve jetësore, përmirësim të sjelljes/qasjes ndaj një veprimi të caktuar siç është diskriminimi ndaj grupeve të caktuara etj.



Por, mbani mend, treguesit vetëm tregojnë. Nganjëherë, duhet të shikoni se çfarë ka bërë një tregues (çfarë ndryshon) dhe të pyesni "përse?" – përse po ecën kaq shpejt apo ngadalë, përse po shkon përpara apo prapa, përse po i tejkalon apo nuk po përkon me pritshmëritë tona. Zakonisht, kur treguesit ju bëjnë të ditur se diçka nuk po shkon siç ishte planifikuar, është koha për të menduar për vlerësimin e këtij treguesi.

Bëhuni selektiv! Mos harroni kostot që lidhen me të dhënat, grumbullimin dhe analizat. Kufizoni numrin e treguesve të përdorur për të ndjekur secilin aktivitet ose rezultat. Zgjidhni vetëm ato që përfaqësojnë dimensionet më themelore dhe të rëndësishme të qëllimit të PVV-së!

3 Hapi 3. Përcaktoni pikënisjet dhe objektivat (synime) ndër vite të treguesve

Grumbullimi i të dhënave fillestare të treguesit përfshin përshkrimin dhe matjen e kushteve fillestare të këtij treguesi. Kjo përbën edhe matjen e parë të treguesit dhe përcakton pikënisjen.

Planifikimi për përmirësime kërkon vendosjen e objektivave realiste. Është e dobishme të përcaktohen objektiva të përkohshëm, që specifikojnë sa progres drejt një rezultati do të arrihet për çdo vit (ose periudhë tjetër kohore e cila mund të jetë edhe 6-mujore). Matja e rezultateve të arritura kundrejt objektivave të paracaktuara do të na krijojë një panoramë të qartë të progresit ose regresit të treguesit.

4 Hapi 4: Përcaktoni metodën e mbledhjes së të dhënave dhe afatet kohore

Pas krijimit të treguesve të monitorimit, është koha për të vendosur mbi metodat për mbledhjen e të dhënave dhe sa shpesh të dhënat e ndryshme do të regjistrohen/përpunohen për të gjurmuar treguesit. Kjo duhet të jetë një bisedë midis stafit të NjVV-së, palëve të interesit dhe anëtarëve të komunitetit.

Burimi i të dhënave të monitorimit varet kryesisht nga fakti se çfarë treguesi po përpiqet të masë. PVV-ja ka të ngjarë të ketë nevojë për burime të shumta të të dhënave për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve të cilat kanë lidhje me zbatimin e tij. Më poshtë është një tabelë që paraqet disa shembuj se çfarë të dhënash mund të mblidhen dhe si.



Tabela 4. Shembuj të dhënash që mund të mblidhen

Informacioni që do të mblidhet	Burimi i të dhënave
Procesi i zbatimit të PVV-së dhe progresi i tij	<ul style="list-style-type: none"> * Të dhëna /relacione të mbledhura në vazhdimësi nga personeli (raporte, listë prezencë në trajnime, raporte të aktiviteteve ndërgjegjësuere me pakicat rome dhe egjiptiane, foto të aktiviteteve, relacione zyrtare, formularë etj.).
Arritja dhe sukseksi i ndërhyrjes së planit vendor të veprimit në cilësinë e shërbimeve të ofruara anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane.	<ul style="list-style-type: none"> * Sondazhe të vogla me përfituesit kryesorë, siç janë intervistat me përfituesit e shërbimeve ose sondazhe mbi nivelin e kënaqësisë së shërbimit të marrë.
Arritja e ndërhyrjeve të medias të përfshira në PVV	<ul style="list-style-type: none"> * Të dhëna për vlerësimet e mediave, regjistrat e broadcaster -it , analizat në Google, sondazhe të qytetarëve.
Arritja dhe sukseksi i ndërhyrjes së programit në nivelin e popullsisë.	<ul style="list-style-type: none"> * Sondazhe me përfaqësues vendorë.
Të dhëna cilësore në lidhje me rezultatet e ndërhyrjes	<ul style="list-style-type: none"> * Fokus grupet, intervista të thelluara, diskutime të grupeve të synuara, raste studimore. * Studime – ndërthurja e të dhënave dhe sondazheve, një program kërkimor më sistematik që i përgjigjet një pyetjeje të caktuar. * Histori sukseksi – përmbledhje rreth një personi apo grupi njerëzish që janë ndikuar pozitivisht nga zbatimi i PVV-së. Të sigurohen përshkrime të "Historive të suksesshme", që janë shembuj konkret të arritjeve si rezultat i aktiviteteve të planit, dëshmojnë ndryshime ose përmirësime cilësore dhe sasiore.

OShC-të dhe GKV-të luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin rreth problemeve në zbatimin dhe mbështetjen e proceseve të mbledhjes së të dhënave. Duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me pakicat rome dhe egjiptiane, organizatat e shoqërisë civile janë në vendin e duhur për të nxjerrë mësimet e marra nga zbatimi i politikës dhe për t'u shpjeguar anëtarëve të komunitetit rëndësinë e mbledhjes së të dhënave.



5 Hapi 5: Identifikoni rolet dhe përgjegjësitë e M&V

Elementi tjetër i planit të M&V është përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive. Është e rëndësishme që në fazat e hershme të hartimit të PVV-së të vendoset se kush është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave për secilin tregues. Kjo ndoshta do të jetë një përzierje e stafit që do të merret me monitorim vlerësimin, Grupin Institucional të Punës së NjVV-ve , OShC-ve rome dhe egjiptiane, si dhe GKV-të që bashkëpunojnë me NjVV-të për arritjen e qëllimit të planit vendor. Të gjithë do të duhet të punojnë së bashku për të marrë të dhënat e mbledhura me saktësi dhe në kohën e duhur.

Rolet e menaxhimit të të dhënave duhet të vendosen me kontributin dhe dakordësinë e të gjithë anëtarëve të ekipit në mënyrë që të gjithë të kenë kuptuar drejt se çfarë duhet të bëjnë, të dinë se cilët tregues u janë caktuar për të monitoruar, kur duhet të mbledhin të dhënat dhe raportojnë ato, etj. Në këtë mënyrë, kur është koha për raportim të treguesve, nuk ka "surpriza"!

6 Hapi 6: Krijoni një plan analize dhe modelet e raportimit

Pasi të jenë mbledhur të gjitha të dhënat, dikush do të duhet t'i përpunojë dhe analizojë ato, për të plotësuar një tabelë rezultatesh, për rishikim të brendshëm dhe raportim të jashtëm. Ky ka të ngjarë të jetë një menaxher i brendshëm i funksionit të M&V në NjVV.

Plani i M&V duhet të përfshijë një seksion me detaje se cilat të dhëna do të analizohen dhe si do të paraqiten rezultatet. A ka nevojë stafi i NjVV-së të kryejë ndonjë test statistikor për të marrë përgjigjet e nevojshme? Nëse po, cilat janë testet dhe cilat të dhëna do të përdoren në to? Çfarë programi kompjuterik do të përdoret për të përpunuar të dhënat dhe për të bërë tabela raportimi? Excel? SPSS? Këto janë konsiderata të rëndësishme.

Një gjë tjetër e mirë për t'u përfshirë në plan është një tabelë bosh për raportimin e ecurisë së treguesve. Kjo tabelë duhet të përshkruajë treguesit, të dhënat dhe periudhën kohore të raportimit. Ato gjithashtu mund të përfshijnë elementë të tillë si objektivi i treguesit, dhe sa larg/shpejt treguesi ka përparuar drejt atij objektivi. Një shembull i një table raportimi të ecurisë së treguesve është pasqyruar në Shtojcën 1.

Përveç raporteve statistikore, monitorimi i zbatimit të planit vendor të veprimit duhet të shoqërohet me një analizë të thelluar narrative të ndërhyrjes së kryer dhe rezultateve të arritura. Shtojca 2 paraqet një model të hartimit të raportit narrativ të monitorimit të zbatimit të PVV-së.



7

Hapi 7 : Hartoni planin e shpërndarjes së informacionit të përfituar nga zbatimi i planit të M&V tek përfituesit e zbatimit të PVV-së, Këshilli Bashkiak, etj.

Elementi i fundit i planit të M&V përshkruan se si dhe kujt do t'i shpërndahen të dhënat dhe informacioni i përftuar prej tyre. Të dhënat për hir të të dhënave nuk duhet të jenë qëllimi përfundimtar i përpjekjeve të monitorim-vlerësimit. Të dhënat duhet të mblidhen gjithmonë për qëllime të veçanta.

Konsideroni sa vijon:

- * Si do të përdoren të dhënat e M&V për të informuar stafin, organizatat rome dhe egjiptiane, anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane për suksesin dhe progresin e planit vendor të veprimit?
- * Si do të përdoren për të ndihmuar stafin të bëjë modifikime dhe korrigjime të kurseve, sipas nevojës?
- * Si do të përdoren të dhënat për të përmirësuar planet vendore të ardhshme dhe për t'i bërë praktikrat e programeve më efektive?

Plani i M&V duhet të përfshijë plane për shpërndarje të brendshme midis ekipit të NjVV-së, si dhe shpërndarje më të gjerë midis palëve të interesuara dhe donatorëve. Për shembull, një departament i caktuar brenda NjVV-ve mund të dëshirojë të rishikojë të dhënat në baza mujore për të marrë vendime programore dhe për të zhvilluar plane pune të ardhshme, ose OSHC-të për të rishikuar të dhënat dhe progresin e projekteve të tyre. Shpërndarja e materialeve të shtypura ose nëpërmjet faqeve zyrtare të NjVV-ve dhe rrjeteve sociale mund të ndodhë në intervale të shpeshta.

Shtojca 3 është një matricë model, e cila lehtëson punën për hartimin e një plani M&V.

3.3. Udhëzuesi i treguesve

Një dokument i rëndësishëm i cili duhet të jetë pjesë e planit të M&V është udhëzuesi i treguesve. Ky është një dokument që përmban pasaportën e çdo treguesi të PVV-së. Ai do të hartohet menjëherë pas aprovimit të PVV-së dhe do të sjellë një qasje të re në cilësinë e hartimit të raporteve të progresit të treguesve të tij. Gjithashtu, udhëzuesi lehtëson punën e: (i) Drejtorisë së Shërbimeve Sociale; (ii) të gjitha stafeve brenda NjVV-së; (iii) si dhe të aktorëve të tjerë jashtë NjVV-ve, të cilat janë përgjegjëse për grumbullimin e informacionit të PVV-së, për të kuptuar drejt punën që duhet të kryejë secili. Udhëzuesi shërben gjithashtu si lehtësues për evidentimin në kohë reale të problematikave të çështjes së pakicave rome dhe egjiptiane në bashki dhe shërben si bazë në zbatimin e PVV-së. Shtojca 4 paraqet një shembull të pasaportës së një treguesi të planit kombëtar të veprimit për pakicat rome dhe egjiptiane.



4

Metoda e Monitorimit dhe Vlerësimit me Pjesëmarrje (M&VP)



M&V kanë qenë prej kohësh të rëndësishme për të vlerësuar ndryshimin aktual kundrejt objektivave të deklaruara si dhe për të gjykuar nëse ndërhyrja për zhvillim ka qenë e suksesshme apo jo. Kjo zakonisht ka përfshirë ekspertë të jashtëm, që vlerësojnë kundrejt treguesve dhe synimeve të tyre. Institucione të ndryshme gjithnjë e më shumë po kuptojnë se procesi i M&V duhet të ndodhë me pjesëmarrjen e një game më të gjerë të aktorëve, duke e bërë kështu mekanizmin e M&V më pjesëmarrës. M&VP përfshin vlerësimin e ndryshimit përmes proceseve, që përfshijnë shumë njerëz ose grupe, ku secili kontribuon ose preket nga ndikimet që vlerësohen. M&VP ka të bëjë me forcimin e përfshirjes së aktorëve kryesorë si pjesëmarrës aktivë në ndërhyrjet e tyre si dhe përfitues të ndërhyrjeve duke marrë drejtimin në gjurmimin dhe analizimin e progresit drejt rezultateve të dakordësuara së bashku. Kjo qasje kontribuon në planifikimin dhe marrjen e vendimeve të drejtuara nga "kërkesat" ose "nevojat", si dhe ndikon në përmirësimin e llogaridhënies.



M&VP përkufizohet si një proces ku palët kryesore të interesit (ata që preken nga ndërhyrja) dhe shoqëria civile janë pjesëmarrës aktivë në gjurmimin e përparimit drejt arritjes së rezultateve të përzgjedhura nga ata vetë, ose të dakordësuara bashkërisht me institucionet vendore.

M&VP ka si synim të vlerësojë informacionin, të lehtësojë kryerjen e procesit të M&V nga përfituesit direkt ose indirekt të një plani vendor veprimi dhe të rrisë angazhimin dhe mirëkuptimin e përfituesve në hartimin, planifikimin dhe zbatimin e masave të bazuara në komunitet. M&VP përfshin përfituesit vendorë në matjen, regjistrimin, mbledhjen, përpunimin dhe komunikimin e informacionit për të ndihmuar institucionet vendore ose qendrore në vendimmarrje. Kjo metodë është në përputhje me parimin e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së qasjes ndaj të drejtave të njeriut të Këshillit të Evropës. Angazhimi i shoqërisë civile dhe grupeve të cenueshme në hartimin, zbatimin dhe monitorim vlerësimin e projekteve është domethënia e këtij parimi. Kontributet nga organizatat e ndryshme të shoqërisë civile në punën e vazhdueshme me përfituesit e projekteve janë gjithashtu një burim i vlefshëm informacioni.²⁴

24 CoE (2020). Council of Europe: Human Rights Approach Practical Guide for Co-operation Projects, Council of Europe, December 2020 <https://rm.coe.int/coe-humanrightsapproach-r01-v05-light-final-version/1680a22410> , f. 13 & 17)



5

Harmonizimi i PVV-ve për pakicat rome dhe egjiptiane me Planin Kombëtar – rasti i raportimit përmes sistemit elektronik "ROMALB"



Plani kombëtar për pakicat rome dhe egjiptiane²⁵ është një angazhim i qeverisë shqiptare, i cili synon pakicat rome dhe egjiptiane. Ky plan hartohet në konsultim të ngushtë me ministrinë përgjegjëse të linjës, përfaqësues nga pakicat rome dhe egjiptiane, NjVV, OShC-të, si dhe aktorë të tjerë. Çdo plan i ri kombëtar bazohet në të dhënat e 5 viteve të mëparshëm të planit kombëtar paraardhës, në përpjekje për eliminimin e problematikave në fushat e regjistrimit civil, arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor, strehimit, mbrojtjes sociale dhe antixhopsizmit.

Financimi për zbatimin e masave të parashikuara në planin kombëtar, parashikohet në buxhetin e shtetit, pas një vlerësimi të fondeve të disponueshme në ministrinë përkatëse të linjës. Gjithashtu, fondet dhe lloje të tjera burimesh të ofruara nga NjVV dhe shoqëria civile janë thelbësore për nxitjen e përfshirjes në nivel vendor, por ato nuk pasqyrohen në planin kombëtar të veprimit, i cili fokusohet në angazhimet, aktivitetet dhe buxhetet e qeverisjes qendrore. Zbatimi i planit kombëtar të veprimit për pakicat rome dhe egjiptiane, prej Ministrisë përgjegjëse për koordinimin ndërinstitucional, realizohet me përfshirjen e drejtpërdrejt të pikave fokale në ministrinë e linjës, si dhe çdo pike fokale në NjVV. Zbatimi i suksesshëm i planit kombëtar të veprimit, varet nga bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet aktorëve të ndryshëm, kryesisht i institucioneve të qeverisjes qendrore e vendore dhe organizatave të shoqërisë civile.

Në fillim të vitit 2013, qeveria shqiptare ka vënë në funksionim përdorimin e sistemit elektronik online "ROMALB", përmes adresës www.romalb.org. Ky sistem përbën një platformë elektronike në internet që lehtëson mbledhjen e të dhënave në kohë reale dhe në nivel kombëtar, të cilat kanë lidhje me pakicat rome dhe egjiptiane. Në këtë platformë hidhen dhe përditësohen të dhëna për treguesit e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2016-2020) dhe, aktualisht, do të mblidhen të dhëna për Planin e ri Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025. Kjo platformë kontribuon në:

- * Lehtësimin e mbledhjes së të dhënave dhe harmonizimin e statistikave në kohë reale, për nivele të ndryshme ndërhyrjesh, në nivel qendror dhe vendor, për pakicat rome dhe egjiptiane;
- * Monitorimin dhe analizën e të dhënave në nivel kombëtar të treguesve të Planit Kombëtar të Veprimit;
- * Përmirësimin e cilësisë së raportimeve të gjeneruara nga stafi i MShMS, Ministrinë e linjës, si dhe NjVV;
- * Monitorimin e ndërhyrjeve dhe vlerësimin e situatës, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës së pakicave rome dhe egjiptiane.

25 Plani më i fundit mund të aksesohet këtu: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/46eb57a0095aac6d46fe42b6cfb302f66368453e0c284a07c0c7c9fd8d43760b.pdf>



Sistemi elektronik "ROMALB" bën të mundur që të dhënat e hedhura në të gjitha nivelet të jenë të disponueshme në kohë reale si dhe raportet e treguesve, përfshirë edhe treguesit që mbledhen nga NjVV-të, të gjenerohen automatikisht dhe pa vonesa.

Qëllimi i përgjithshëm i përdorimit të këtij sistemi në nivel kombëtar dhe vendor është që, nëpërmjet informacionit të marrë nga mbledhja cilësore e të dhënave në të gjitha nivelet, të sigurohet që romët dhe egjiptianët të kenë qasje në të njëjtat shërbime dhe të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre njësoj si çdo shtetas tjetër shqiptar. Institucionet kontribuuese me të dhëna në cilësinë e grumbullimit të tyre janë pikërisht ato institucione, që janë më pranë komunitetit dhe ku të dhënat gjenerohen, siç janë: shkollat, qendrat shëndetësore, zyrat e gjendjes civile, qendrat komunitare, organizatat e shoqërisë civile – përfshirë organizata rome dhe egjiptiane, zyrat e strehimit pranë NjVV-ve, zyrat e punës pranë NjVV-ve, etj. Grumbullimi i të dhënave në "bazë" përmirëson cilësinë e tyre dhe për rrjedhojë, informacionin e përfutur prej tyre.

NjVV-të janë përgjegjëse për të mbledhur dhe raportuar tregues që janë pjesë e planeve kombëtare për pakicat rome dhe egjiptiane. Treguesit e mbledhur nga NjVV-të janë një ndërthurje e treguesve të të gjitha ministrive të linjës, në fushat përkatëse, si: strehimi, shëndetësia, arsimit, regjistrimi civil, mbrojtja sociale dhe antixhopsizmi. Pikat fokale për çështjet rome dhe egjiptiane në Ministrinë e Linjës (Ministria e Arsimit, MShMS, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme) kanë akses të shohin të dhënat e treguesve të hedhura nga NjVV-të të cilat i përkasin fushave të tyre. P.sh.: pika fokale në Ministrinë e Arsimit mbikëqyr cilësinë e të dhënave të hedhura për treguesit që i përkasin fushës së arsimit etj. Në këtë mënyrë, kontrolli i cilësisë së të dhënave të hedhura në "ROMALB" nga NjVV-të kryqëzohet midis kontrollit në përmbajtje që bën çdo ministri linje, me atë që bën pika fokale në MShMS.

Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore (DPSBGj) pranë MShMS, çdo vit, merr masa për trajnimin dhe ofrimin e mbështetjes teknike të vazhdueshme të përdoruesve të sistemit elektronik "ROMALB", përfshirë këtu të gjitha NjVV-të e vendit, për çeljen e llogarive për përdoruesit e rinj të sistemit, shpjegimin e përkufizimit të treguesve, afatet kohore të raportimit, hierarkinë e rishikimit dhe aprovimit të të dhënave të treguesve të monitorimit, përditësimin e tyre, si dhe për administrimin e përshtatshëm të këtij sistemi.



6

Përfundime dhe rekomandime





Zhvillimi i kuadrit të M&V të PVV-ve është më shumë se një produkt i shkruar. Ai është kulmi i një procesi bashkëpunues, duke krijuar mundësi të mjaftueshme për t'u angazhuar me aktorët kryesorë të PVV-ve, të cilët do të zbatojnë procesin e M&V. Kjo qasje rrit mundësitë që procesi i M&V të zbatohet dhe përdoret për të udhëhequr proceset e reflektimit dhe të mësuarit.



Zhvillimi i PVV-ve për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane mund të ndihmojë palët e interesuara vendore t'i kthejnë vizionet e tyre në realitet dhe të rrisin efikasitetin dhe llogaridhënien brenda NjVV-ve. Një PVV përshkruan mënyrën se si NjVV-ja do të përmbushë objektivat e saj përmes hapave të detajuar të veprimit, që përshkruajnë se si dhe kur do të ndërmerren këta hapa.



Krijimi i një PVV-je u jep bashkive një udhëzues të qartë drejt suksesit. Kjo ndihmon në prioritizimin e qëllimeve, maksimizimin e burimeve, rritjen e besimit të publikut dhe marrjen e vendimeve më të mira, duke rritur efikasitetin dhe efektivitetin e bashkisë, ndërsa kjo e fundit zbaton strategjinë e saj.



7

Rekomandime



Në këtë pjesë të fundit ofrohen rekomandime për aktorët kryesorë se si mund ta bëjnë kontributin e tyre në proces edhe më efektiv.

* Qytetarët dhe OSHC-të pakicave rome dhe egjiptiane

Përfaqësuesit e pakicave rome dhe egjiptiane duhet të vizitojnë NjVV-të disa herë në vit, me qëllim që të informohen për zbatimin sa më të mirë të PVV-së dhe për të përballuar çdo sfidë.

OSHC-të luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin rreth problemeve në zbatimin dhe mbështetjen e proceseve të M&V-ve. Duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me pakicat rome dhe egjiptiane, OSHC-të janë në vendin e duhur për të nxjerrë mësimet e marra nga zbatimi i politikës dhe për t'u shpjeguar anëtarëve të komunitetit rëndësinë e M&V-së.

* Njësitë e vetëqeverisjes vendore

NjVV-të do të duhet (të vazhdojnë) realizimin e proceseve me pjesëmarrje, në të cilat pjesëmarrja e grupeve të interesit është një proces i vazhdueshëm, inputet e tyre merren në konsideratë, si dhe pjesëmarrja e tyre nuk është vetëm një procedurë apo disa foto të postuara në mediat sociale.

NjVV-të duhet të përforcojnë një qasje të bazuar në rezultate gjatë planifikimit të M&V, të realizojnë raportime periodike bazuar në rezultate të matshme, si një mënyrë e standardizuar për komunikuar me qytetarët në mënyrë të përgjigjshme.

Sic është theksuar edhe më herët, M&V nuk mund të kuptohen pa kërkimin, ndaj është e domosdoshme që NjVV-të të ndërmarrin hapa konkretë dhe praktikë për ndërtimin jo thjesht të kapaciteteve për M&V, por edhe për kërkim. Kjo do garantonte akses në të dhëna me cilësi dhe të besueshme.

Vazhdimësia/persistenca është një tjetër tipar suksesi për M&V. Përprjekjet e NjVV-ve në këtë drejtim duhet të jenë të vazhdueshme dhe jo momentale/sporadike apo të varura nga ndihma dhe mbështetje të jashtme.

Ndarja e praktikave të mira ndërmjet NjVV-ve mund të ndihmojë në maksimizimin e efekteve të praktikave të mira dhe mësimet të nxjerra nga NjVV pioniere apo më të përparuara.

Një koordinim dhe sinergji më e mirë kërkohet jo vetëm brenda dhe midis departamenteve të ndryshëm të NjVV-ve, por edhe midis këtyre të fundit dhe aktorëve të tjerë që veprojnë në nivel vendor.

Një detyre edhe më specifike për NjVV-të është që të vijnë të ushqejnë dhe përditësojnë sistemin "RO-MALB" me të dhëna për treguesit e Planit të Veprimit Kombëtar për pakicat rome dhe egjiptiane. Kjo, në vazhdimësi të punës për mbledhjen e të dhënave në mënyre periodike për treguesit e PVV-ve të tyre dhe përgatitjen e raporteve të monitorimit. Raporti i monitorimit të progresit të zbatimit të objektivave



dhe masave të PVV -ve duhet të paraqitet në mënyrë periodike, çdo vit (brenda muajit mars të vitit pas-ardhës) dhe duhet të jetë pjesë e diskutimeve në takimet e të gjithë aktorëve në nivel vendor. Një raport përmbledhës i rezultateve të arritura nga zbatimi i PVV-së, analiza e performanës së treguesve përgjatë viteve, mësimet e nxjerra, histori suksesi, etj., duhet të finalizohet gjithashtu tre muaj pas përfundimit të afatit kohor të PVV-së.

Raporti i monitorimit të zbatimit të aktiviteteve të planit të veprimit për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane është një dokument i cili duhet të jetë i dukshëm dhe i aksesueshëm. Në këtë kuadër, masa të mëtejshme duhen ndërmarrë për t'i bërë rezultatet e PVV-ve të dukshme dhe të arritshme për të gjithë grupet e synuara prej tij. Të tilla janë masa që kanë lidhje me shpërndarjen e rezultateve të PVV-ve të cilat kanë për qëllim:

- * Promovimin – Informimi dhe edukimi i të gjitha komuniteteve të interesuara;
- * Informimin – Rezultatet e zhvilluara përmes PVV-së të jenë në dispozicion të audiencave të ndryshme të synuara;
- * Angazhimin – Marrja e komenteve dhe rekomandimeve nga grupet e ndryshme të synuara në lidhje me procesin e zbatimit të PVV-së ;
- * Qëndrueshmërinë – Sigurimi që rezultatet e zbatimit të PVV-së të jenë të qëndrueshme pas përfundimit të jetëgjatësisë së saj.

* Qeverisja qendrore

Ka hapësirë për një rol më të madh të qeverisjes qendrore në inkurajimin, mbështetjen dhe motivimin e NjVV-ve në rrugën drejt zhvillimit të kulturës së M&V për një qeverisje sa më të përgjegjshme dhe të përgjigjshme në nivel vendor (p.sh. përmes ofrimit të ekspertizës, trajnimeve, etj.; alokimit të buxheteve bazuar në rezultate që monitorohen, vlerësohen dhe raportohen vazhdimisht; etj.).

Qeverisja qendrore mund të bëjë një përdorim më të mirë dhe më të dukshëm të të dhënave që gjenerohen në nivel vendor dhe të përforcojë qasjen e politikëbërjes dhe vendimmarrjes së bazuar në evidenca.



8

Referenca



Burch, P., & Heinrich, C. (2016). *Mixed methods for policy research and program evaluation*. SAGE Publications, Inc. <https://www.doi.org/10.4135/9781483398259>

CoE (2020). *Council of Europe: Human Rights Approach Practical Guide for Co-operation Projects*, Council of Europe, December 2020 <https://rm.coe.int/coe-humanrightsapproach-r01-v05-light-final-version/1680a22410>

CoE (2016). *Council of Europe: Project Management Methodology Handbook 2016*, Council of Europe, March 2016 http://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/en/wp-content/uploads/2020/01/PMM-Handbook-2016-v6.pdf_compressed_compressed.pdf

CoE (2008). *12 Principles of Good Governance*, Council of Europe, <https://www.coe.int/en/web/good-governance/12-principles>

Creswell, J. W., & Creswell, J. D. (2018). *Research design: qualitative, quantitative, and mixed methods approaches*. Fifth edition. Los Angeles: SAGE.

Fhi360 (2004). *Monitoring HIV/AIDS Programs: A Facilitator's Training Guide; A USAID Resource for Prevention, Care and Treatment*. <https://www.fhi360.org/sites/default/files/media/documents/Monitoring%20HIVAIDS%20Programs-A%20Facilitator%E2%80%99s%20Training%20Guide.pdf>

IFRCS (2007). *Monitoring and Evaluation in a Nutshell*. Planning, Monitoring, Evaluation and Reporting Department, IFRCS. https://sswm.info/sites/default/files/reference_attachments/RED%20CROSS%20and%20RED%20CRESCENT%202007%20Monitoring%20and%20Evaluation%20in%20a%20Nutshell.pdf

GRAMAY II (pa date). *Participatory Monitoring & Evaluation (PME) Action Plan*. <http://www.wmduk.gov.in/ManualsUDWDP/TM/PME.pdf>

Johnson, G. (2002). *Research methods for public administrators*. Westport, CT: Quorum Books. Chicago

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2015). *Plani Kombëtar për Integrimin e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane (2016-2020)*

OECD (2021). *Applying Evaluation Criteria Thoughtfully*, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/543e84ed-en>.

Patton, MQ. (1999). "Enhancing the quality and credibility of qualitative analysis." *HSR: Health Services Research*. 34 (5) Part II. pp. 1189-1208.

Schoonenboom, J., & Johnson, R. B. (2017). How to Construct a Mixed Methods Research Design. *Kolner Zeitschrift fur Soziologie und Sozialpsychologie*, 69(Suppl 2), 107–131. <https://doi.org/10.1007/s11577-017-0454-1>

TANGO (2007). *Monitoring and Evaluation Manual*, Prepared for ADRA International Food Security Department, TANGO International, Inc. March 2007

UNAIDS (pa datë). *Monitoring and Evaluation Fundamentals. An Introduction to Indicators*. https://www.unaids.org/sites/default/files/sub_landing/files/8_2-Intro-to-IndicatorsFMEF.pdf



9

Shtojcat



Shtojca 1:

Shembull i raportimit të ecurisë së treguesve

Treguesi	Pikënisja	Arritja e Vitit 1	Objektivi i synuar për vitin 1	% e arritjes kundrejt objektivit të synuar për vitin 1	Arritja e Vitit 2	Objektivi i synuar për vitin 2	% e arritjes kundrejt objektivit të synuar për vitin 2
Numri i trajnimeve të mbajtura me ofruesit e shëndetit publik në lidhje me shërbimet shëndetësore për pakicat rome dhe egjiptiane.	0	5	10	50%	6	12	50%
Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë nga shërbimet shtesë në rastet e pamundësisë për të paguar detyrimet financiare për një program strehimi.	0	60	100	60%	30	120	25%
Përqindja e familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë nga programi i subvencionimit të qirasë në treg të lirë (bonus qiraje) kundrejt pjesës tjetër të popullsisë.	5%	35%	75%	47%	25%	80%	31%



Shtojca 2:

Modeli i raportimit narrativ vjetor të PVV-së26 (viti 2021)

Logo e bashkisë

Raport Monitorimi mbi zbatimin e Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane

(2019-2022)

Bashkia: _____

Lista e shkurtimeve

I. Përmbledhje ekzekutive

Një përmbledhje e të gjithë raportit të monitorimit duke u fokusuar më së shumti në një përmbledhje të arritjeve të deritanishme të cilat janë identifikuar përmes procesit të monitorimit, realizimeve/mosrealizimeve të objektivave specifike dhe masave, një përmbledhje e aktorëve të përfshirë në procesin e monitorimit etj.. – deri në 2 faqe

II. Hyrje

Prezantim i kontekstit dhe qëllimit të përgatitjes së këtij dokumenti. Periudha që mbulon raporti. Çfarë informacioni të përgjithshëm përmban ky dokument. Përshkrim i faktorëve të rëndësishëm të cilët ndikuan në realizimin/mosrealizimin e masave (si p.sh. Pandemia COVID 19, tërmeti i vitit 2019). Falenderime për të gjithë aktorët që u përfshinë në hartimin e këtij raporti etj. – deri në 1 faqe

III. Metodologjia

Qasja dhe metodat e përdorura për realizimin e procesit të monitorimit dhe raportimit të tij. Të tillë mund të jenë:

26 Në këtë model supozojmë se i referohemi një PVV-je për periudhën 2019-2022



- i. rishikim të raporteve të prodhuara nga departamente të Bashkisë dhe që janë përgjegjëse për zbatimin e masave specifike (të tillë mund të jenë: zyra arsimore, zyra e punës, zyra e regjistrimit civil, NjVKSh, departamenti i strehimit);
- ii. mbledhje të dhënash përmes instrumenteve të dedikuara siç janë tabela e treguesve dhe masave (referoju modelit të mëposhtëm) e cila i dërgohet departamenteve brenda bashkisë ose institucioneve jashtë saj, përfshirë edhe OJF për t'u plotësuar;
- iii. të dhënat nga sistemi ROMALB. Në këtë raport monitorimi do të raportohen masa dhe tregues të zbatuara sipas buxhetit të parashikuar në këtë plan vendor ose masa të zbatuara nga donatorë bazuar në një marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë. – deri në $\frac{3}{4}$ faqe

IV. Përshkrim i përgjithshëm i Planit vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane (2019-2022) të Bashkisë X

Një përshkrim i dokumentit PVV në të cilën mund të përfshihen: aktorët që mbështetën hartimin e kësaj PVV-je; vizioni, qëllimet strategjike; objektivat specifike; rezultatet e pritshme etj.. – deri në 1 faqe

V. Sfida të hasura gjate zbatimit të Planit Vendor

Cilat kanë qenë problematikat, sfidat dhe kufizimet kryesore të identifikuara? P.sh. të tilla mund të jenë evidenca të munguara për masa të zbatuara, buxhete jo të parashikuara edhe pse janë të aprovuara në plan, mungesë kapacitetesh të stafit vendor për zbatimin e masave të caktuara, mungesë koordinimi mes departamenteve dhe zyrave brenda bashkisë për raportimin e të dhënave të treguesve etj.. – deri në $\frac{1}{2}$ faqe

VI. Mundësitë për përmirësim në të ardhmen

Cilat janë mundësitë për t'i adresuar/tejkalluar ato në vijimësinë e zbatimit të planit? – deri në $\frac{1}{2}$ faqe

VII. Buxheti

Një pasqyrë krahasuese midis buxhetit të propozuar, planifikuar dhe shpenzuar. Shpjegime mbi gjendjen e pasqyruar. Në këtë tabelë buxheti do të detajohet në nivel fushash. – deri në 2 faqe



Nr. Fusha	Viti 2020					Viti 2021				
	Buxheti i propozuar në PVV	Buxheti i planifikuar në PVV	Shpenzime fakt	Diferenca (plan-fakt)	% e realizimit të shpenzimeve	Buxheti i propozuar në PVV	Buxheti i planifikuar në PVV	Shpenzime fakt	Diferenca (plan-fakt)	% e realizimit të shpenzimeve
Arsimi										
Strehimi										
Shëndetësia										

VIII. Përfundime dhe rekomandime – deri në 1 faqe

IX. Vlerësimi i zbatimit të masave të Planit Vendor

Modeli i plotësuar me informacion sasior dhe cilësor të zbatimit të masave si dhe treguesve për secilën fushë dhe secilën masë të parashikuar, shoqëruar gjithashtu me buxhetet përkatëse.

Modeli i matricës së raportimit narrativ dhe statistikor të PVV-së²⁷ (periudha e raportimit: 2019-2021)²⁸

Fusha: [shkruani fushën e ndërhyrjes siç është në dokumentin e PVV-së]

Qëllimi: [Shkruani "qëllimin" e fushës së ndërhyrjes, siç është në dokumentin PVV-së]

Buxheti total i propozuar në PVV për këtë fushë	[Fusni buxhetin total të propozuar në PVV për këtë fushë, për çdo vit që përkon me periudhën e monitorimit]
Viti 2019	LEKË
Viti 2020	LEKË
Viti 2021	LEKË

27 Në këtë model supozojmë se i referohemi një PVV-je për periudhën 2019-2021

28 Për të ardhur në ndihmë të bashkive, disa të dhëna të kësaj tabele do të plotësohen nga konsulentët. Të tilla të dhëna janë: masa, treguesi dhe buxheti i propozuar.



Buxheti total i parashikuar në PVV për këtë fushë	[Fusni buxhetin total të alokuar në PVV për këtë fushë, për çdo vit që përkon me periudhën e monitorimit] Viti 2019 _____ LEKË Viti 2020 _____ LEKË Viti 2021 _____ LEKË
Buxheti total i shpenzuar në PVV për këtë fushë	[Fusni buxhetin total të shpenzuar në PVV për këtë fushë, për çdo vit që përkon me periudhën e monitorimit] Viti 2019 _____ LEKË Viti 2020 _____ LEKË Viti 2021 _____ LEKË
Objektivi 1:	[Fusni tekstin e plotë të objektivit 1, siç përshkruhet në dokumentin e PVV-së]
Treguesi i Objektivit:	[Fusni tekstin e plotë të treguesit të objektivit 1, siç përshkruhet dokumentin e PVV-së]
Realizimi i Objektivit:	[Përshkruani në çfarë mase është arritur ky objektivi. Referohuni gjithë së përdorur në formulimin e treguesit për të shpjeguar realizimin e objektivit]

Masat nën objektivin 1	Shpjegime të detajuara mbi realizimin e masave /aktiviteteve	Treguesi	Ecuria e treguesit	Buxheti në Lekë		
				I propozuar në PVV	I parashikuar në buxhet	I shpenzuar në fakt
Shkruani masën siç është në dokumentin e PVV-së.	Shkruani qartë informacionin mbi rrjedhën e përgjithshme (shtrirja tek romët dhe egjiptianët) institucionet dhe partnerët zbatues përgjegjës, angazhimi i romëve në zbatim të kësaj mase dhe roli i tyre, përditë udha e zbatimit, kontributi drejt objektivit, vlerat e shtuara (anti-diskriminimi, gjinia, lidhja me masat e tjera, etj.) dhe informacione të tjera me rëndësi.	Shkruani treguesin i cili shërben për të monitoruar këtë masë siç është në dokumentin e PVV-së.	Për çdo vit të raportimit jepni numrin e përfituesve total, produktet e realizuara, si rezultat i zbatimit të aktivitetit si dhe ndarjen sipas kërkesave të treguesit (referohu dokumentit të PVV-së për nën-ndarjet e treguesit p.sh. gjinia, shpërndarja gjeografike -zonë rurale/urbane, etnia etj.). Këto të dhëna mund t'i strukturoni sipas tabelës së mëposhtme:	Viti 2019 _____	Viti 2020 _____	Viti 2021 _____



Shtojca 3:

Model Matrica për sistemin e Monitorimit dhe Vlerësimit dhe Buxhetit të Planit Vendor të Veprimt

Qëllimi strategjik:									
Treguesi i qëllimit strategjik të planit vendor të veprimt									
Objektivi 1:									
Treguesi i Objektivit 1									
Aktivitetet	Treguesit:	Të dhënat bazë për treguesin:	Target për çdo vit	Burimi i të dhënave:	Autoriteti përgjegjës:	Monitorimi /raportimi:	Afati:	Vlerësimi paraprak:	Financimi:
Aktivitetet kyçe që duhet të realizohen me qëllim arritjen e objektivit.	Treguesit janë elemente që ndryshojnë, të cilët tregojnë se jeni duke arritur progres në atë që keni përcaktuar të bëni (objektivi). Treguesit përgjithësisht tregojnë ndryshime në sasi (numri i elementeve që kanë ndodhur ose janë përgatitur), cilësi (nëse diçka po përmirësohet apo përqeshohet), drejtim (a po ndjek një procedurë e caktuar një tendencë ngjithëse apo zbritëse), shpejtësi (sa shpejt po bëhet progres). Ndonjëherë ne monitorojmë kostot për sa i përket kostos për kryerjen e një numri të caktuar masash, megjithëse ky është zakonisht funksion i financës. Së fundmi, ju mund të monitoroni mbi baza pohuese apo mohuese, nëse diçka ka ndodhur apo jo.	Baza krahasuese është situata para fillimit të një programi ose aktiviteti; ky është hapi fillestar për monitorimin e rezultateve.	Një rezultat specifik, i matshëm dhe i përcaktuar me kohë (rezultat) që kontribuon drejtpërsëdrejti në arritjen e një qëllimi.	Identifikimi se kush/cili (pozicioni) nëpunës shtetëror në nivel vendor ose organizata jo-qeveritare është përgjegjës për ofrimin e të dhënave për NJW.	Identifikimi i aktorëve brenda dhe jashtë NJW, pozicionit të tyre specifik i cili do të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për mbledhjen e të dhënave.	Drejtoria brenda NJW-së përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së të dhënave, monitorimin e progresit të treguesve të performancës dhe përgatitja e raportit të tij/të saj vjetor të progresit.	Përshkrimi sesa shpesh të dhënat do të merren nga Njësia Operative, dhe kur (shpesh të Njësia). Nëse ky është një aktivitet i caktuar në afatin e tij të zbatimit. Përcaktoni afatin e zbatimit të këtij aktiviteti (fillimi/përfundimi i vitit të aktivitetit).	Cila është kostoja e zbatimit të këtij aktiviteti? Nëse ky është një aktivitet i caktuar në afatin e tij të zbatimit. Përcaktoni një kosto të logaritit.	Burimet e mundshme: Cilat janë burimet e mundshme për zbatimin e këtij aktiviteti për periudhën kohore të caktuar në afatin e tij të zbatimit.



Shtojca 4:

Shembull i pasaportës së treguesit të planit të M&V

Treguesi: 1.10.2 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë shtesën në ndihmën ekonomike bazuar në arsimimin e fëmijëve të tyre.

Fusha Prioritare: MBROJTJA SOCIALE

Qëllimi Strategjik: Rritja e aksesit në programet e mbrojtjes sociale për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane.

Objektivi 1: Përmirësimi i përfshirjes së anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane në programet e mbrojtjes sociale.

Aktiviteti 1.10. Familjet rome dhe egjiptiane, fëmijët e të cilëve ndjekin rregullisht arsimin e detyrueshëm dhe vaksinohen, do të përfitojnë një shumë shtesë të ndihma ekonomike, që të nxisë vijueshmërinë në shkollë.

TË DHËNA TË TREGUESIT

PËRSHKRIMI I TREGUESIT

Bazuar në vendimin Nr. 955, datë 7.12.2016 Ndhima ekonomike, për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, e cila kufizohet në kohë, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet. Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike nuk aplikohet ndër të tjera për familjet me kryefamiljare gra, me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë. Totali i familjeve rome dhe egjiptiane të cilat plotësojnë këtë kriter do të raportohet në këtë tregues.

Njësia e matjes:

Numër i familjeve.

Ndarja sipas:

Etnisë, vendndodhja gjeografike (rurale/urbane).

PLANI PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE

Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Zyra e ndihmës ekonomike pranë NjVV-së gjeneron këto të dhëna nga sistemi i ndihmës ekonomike e cila funksionon pranë çdo NjVV-je.

Burimi i të dhënave

Zyra e ndihmës ekonomike pranë NjVV-së.

Frekuenca e mbledhjes së të dhënave

Vjetore.

Personat përgjegjës për mbledhjen e të dhënave

Punonjësi i zyrës së ndihmës ekonomike pranë NjVV-së, i cili mirëmban sistemin e ndihmës ekonomike.



Instrumenti për mbledhjen e të dhënave	
VLERËSIMI I CILËSISË SË TË DHËNAVE	
Njohja e kufizimeve të të dhënave	Në shifrat e raportuara mund të jenë përfshirë edhe familje të cilat nuk i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane.
Plane për vlerësimin e cilësisë së të dhënave	Raportet që gjenerohen nga sistemi elektronik i ndihmës ekonomike rishikohen dhe vlerësohen nga stafi i Departamentit të shërbimit social pranë NjVV-së për një periudhë 6-mujore.
PLANI PER ANALIZIMIN, RISHIKIMIN DHE RAPORTIMIN	
Analiza a të dhënave	Analizimi i të dhënave është i thjeshtë, duke bërë krahasimin me shifrat në pikën e nisjes (viti baseline) si dhe me synimet (target) për çdo vit. Interpretimi i të dhënave do të përqendrohet në faktorët e mundshëm që ndikojnë në performancën e lartë ose të ulët të treguesit.
Prezantimi i të dhënave	Në nivel NjVV-je të dhënat hidhen në sistemin ROMALB nga pika fokale pranë saj në rastin kur treguesi është edhe në planin kombëtar të veprimit. Gjithashtu të dhënat për çdo tregues hidhen në një dokument Excel sipas tabelës 4.
Rishikimi	Personi përgjegjës në Drejtorinë e Shërbimit Social (pika fokale), bën rishikimin e të dhënave të hedhura në sistemin ROMALB si dhe në sistemin elektronik që përdor NjVV-ja për të përpunuar të dhënat e treguesve dhe pasi ato janë të sakta me aprovimin e tij/saj kalojnë si të aprovuara për tu raportuar në listën e treguesve të Planit Kombëtar të Veprimit për Pakicat Rome dhe Egjiptiane në MShMS.
Raportimi	Brenda datës 15 Janar të vitit pasardhës
TË DHËNA TË TJERA	
Pika e nisjes (baseline)	930 familje
Synimi	3% rritje çdo vit deri në vitin 2020
Ruajtja e të dhënave	Sistemi elektronik "ROMALB" për treguesit e planit kombëtar dhe tabela në Excel, SPSS, ACCESS për të gjithë treguesit e planit vendor të veprimit.
Shënime të tjera	
DATA E KRIJIMIT:	DATA E NDRYSHIMIT TË FUNDIT:



ROMACTED

Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor

Ky publikim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën e diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës